



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E PËRMBARUESVE GJYQËSORË PRIVATË



Nr. 106 Prot
Nr. 1869 Dosje

Tiranë, më 20.02.2024

VENDIM

PER PUSHIMIN E EKZEKUTIMIT

Unë Altin Vako, me detyrën e Përmbaruesit Gjyqësor, në referim të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. (11.2024-154) 1166/244, datë 18.01.2024 të lëshuar prej Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, kam vënë në ekzekutim këtë Urdhër, duke regjistruar në dosjen përbarimore Nr. 1869, Datë 05.02.2024, kërkesën e kreditorit Shoqërisë "GTACC" Sh.p.k., ndaj debitorit, Shoqërisë "Top Seven" Sh.p.k., në lidhje me titullin ekzekutiv, Faturë Tatimore Shitje Nr. 13/2023, datë 13.06.2023

Pasi fillova ekzekutimin e detyrueshëm duke i dërguar debitorit lajmërimin Nr. 75 Prot, datë 07.02.2024 për të ekzekutuar vullnetarisht detyrimin, kam kaluar në vënien e sekuestros konservative tek kreditë, aksionet dhe asetet e Shoqërisë "Top Seven" Sh.p.k.

Urdhërat për vendosjen e sekuestrove konservative janë dërguar nga Përmbaruesi Gjyqësor Altin Vako pranë:

- Qendrës Kombëtare të Biznesit me shkresën Nr. 100 Prot, datë 19.02.2024.
- DRSHTRR - Tiranë me shkresën Nr. 101 Prot, datë 19.02.2024.
- Bankave të Nivelit të II-të me shkresën Nr. 102 Prot, datë 19.02.2024.

Lidhur sa më sipër, duke zhvilluar dhe kryer veprimet proceduriale të nevojshme për ekzekutimin e plotë të titullit ekzekutiv me palët e lartpërmendura,

KONSTATOJ

Se në datë 21.02.2024, pas nxjerrjes së llogarisë pranë Banka Kombëtare Tregtare sh.a., ka rezultuar se pala debitore Shoqëria "Top Seven" Sh.p.k., kishte paguar të gjithë vlerën e detyrimit, duke zbatuar vendimin e Gjykatës.



Person Fizik "ALTIN VAKO", Nr. NIPT-i: L51314013N
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë
Tel. 04 23 000 39

Në këto kushte, referuar Nenit 616, Pika (a) të Kodit të Procedures Civile dhe të Ligjit Nr. 26/2019, date 08.05.2019 "Për Shërbimin Përmbartimor Gjyqësor Privat",

VENDOSA

1. Pushimin e ekzekutimit të Urdhërit të Ekzekutimit Nr. (11.2024-154) 1166/244, datë 18.01.2024 të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës, pasi detyrimi është shlyer tërësisht..
2. DRSHTRR - Tiranë të bëjë ç'bllokimin e dokumentacionit të mjeteve që mund të ketë në pronësi Shoqëria "Top Seven" Sh.p.k me Nr. NIPT-i: L72428010U, të bllokuara me anë të shkresës Nr. 101 Prot, datë 19.02.2024 të Përmbartuesit Gjyqësor Altin Vako.
3. Bankat e Nivelit të II-të, të bëjnë ç'bllokimin e depozitave, kredive apo llogarive bankare të Shoqërisë "Top Seven" Sh.p.k me Nr. NIPT-i: L72428010U të bllokuara me anë të shkresës Nr. 102 Prot, datë 19.02.2024 të Përmbartuesit Gjyqësor Altin Vako.
4. Qendra Kombëtare e Biznesit të bëjë ç'bllokimin e aksioneve apo kredive të Shoqërisë "Top Seven" Sh.p.k me Nr. NIPT-i: L72428010U të bllokuara me anë të shkresës Nr. 100 Prot, datë 19.02.2024 të Përmbartuesit Gjyqësor Altin Vako.

Ky vendim mund të ankimohet përpara Gjykatës kompetente, brenda 5-ditësh.

PËRMBARUES GJYQËSOR

ALTIN VAKO



Person Fizik "ALTIN VAKO", Nr. NIPT-i: L51314013N
Adresa: Bulevardi "Gjergj Fishta", Kulla Nr. 5, Kt. VIII, Nr. 37, Tiranë
Tel. 04 23 000 39